



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 97 Prot.

Tiranë, më 25 /01/2016

VENDIM

Nr. 01 ,datë 25/01 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe neneve 80-104 të Kodit të Procedurave Administrative,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra "Res Publica", ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1101 Prot., datë 28.10.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Ministrisë së Mbrojtjes me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare*".

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresën nr.146/1 Prot., të datës 02.10.2015 ka kërkuar nga Ministria e Mbrojtjes t'i vihet në dispozicion *kopje e studimit "Vlerësimi paraprak i riskut mjedisor të eksplozivëve në Fabrikën Mjekës, Shqipëri"*.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Zyra e Komisionerit kontaktoi me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Kjo e fundit me shkresën nr.7905/1 Prot., datë 06.11.2015 i ka kthyer përgjigje Qendrës "Res Publica" duke sqaruar se studimi i kërkuar nuk mund t'i vihet në dispozicion pasi ky studim ka autorë të huaj dhe është për përdorim të brendshëm. Qendra "Res Publica" pretendon se përgjigjia e Ministrisë së Mbrojtjes nuk është e bazuar në ligj pasi, studimi i hartuar nga një subjekt tjetër nuk e kufizon të drejtën për të marrë këtë informacion, sidomos në rastin kur ky studim është bërë për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes. Gjithashtu arsyeja se studimi është për përdorim të brendshëm nuk mbështetet në asnjë parashikim ligjor.

Në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se "*Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*", me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore përpara marrjes së vendimit përfundimtar. Me shkresën nr. 1101/3 Prot., datë 13.11.2015, Zyra e Komisionerit njoftoi palët në një seancë dëgjimore në datën 23.11.2015, ora 11:00 pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit.

Në seancën dëgjimore u paraqit ankuesi, Qendra "Res Publica" i përfaqësuar nga Av.

, Znj. dhe Ministria e Mbrojtjes përfaqësuar me autorizimin nr.4771 prot., datë 23.11.2015 nga Drejtori i Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm dhe Antikorrupsionit pranë Ministrisë së Mbrojtjes Z. dhe Juristi Z.

Palët e sipërcituara pasi paraqitën pretendimet e tyre me gojë, depozituan parashtrimet edhe në formë shkresore.

Qendra "Res Publica" në shkresën me nr.1101/4prot, datë 24.11.2015 parashtron se "Refuzimi për dhënien e studimit me arsyetimin se studimi ka autor të huaj dhe për përdorim të brendshëm nuk është i bazuar në ligj për arsyet si më poshtë vijojnë:

***Së pari,** arsyeja që studimi ka autorë të huaj nuk gjen asnjë mbështetje ligjore. Pika 1 e nenit 1 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shprehet: "Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike."*

Dispozita e mësipërme sanksionon që autoriteti publik ka detyrimin që të verë në dispozicion të kërkuarit dokumentacionin ose informacionin, i cili edhe nëse nuk është prodhuar nga vetë autoriteti, mbahet nga ai.

***Së dyti,** argumenti që studimi është në përdorim të brendshëm, nuk parashikohet në asnjë rast si një prej kufizimeve të listuara në nenin 17 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit". Asnjë arsye apo argument që nuk mbështetet në nenin 17, nuk mund të përdoret për të kufizuar të drejtën e kërkuarit për t'u informuar.*

***Së treti,** edhe nëse do të ishim përpara një rasti kufizimi, si për shembull sekretit shtetëror, ligji thekson parimin se asnjë kufizim nuk është me natyrë absolute. Në çdo rast, Komisioneri ushtron balancën e proporcionalitetit, duke vlerësuar se cili interes është më i lartë. Për të demonstruar se interesi i informimit të palës kërkuese është më i lartë, po parashtojmë arsyet e kërimit të këtij informacioni specifik, ndonëse ligji nuk detyron kërkuarin të bëjë të ditura motivet.*

Qendra "Res Publica" dhe avokatët që punojnë pranë saj, janë përfaqësues të 18 familjeve të 24 prej 26 viktimave të shpërthimit të Gërdecit. Prej shumë vitesh tashmë, Res Publica ka bërë përpjekje në shumë plane për të mbrojtur interesat e këtyre personave, si në planin e drejtësisë penale, civile apo administrative. Dokumenti i kërkuar prej nesh me anë të kërkesës për informim, ka gjasa të hedhë dritë mbi fakte që vlejnë për analizën krahasimore të Uzinës Mjekës me atë të Gërdecit, si dhe shfaq interes për impaktin në mjedis të kësaj uzine dhe vlen edhe për banorët që jetojnë pranë saj. Kujtojmë këtu që informacionet lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç është e drejta e jetës (në aspektin substancial dhe procedural të saj) e mbrojtur nga neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Informacioni i kërkuar prej nesh është reklamuar në një rast në një prezantim të bërë nga NATO (në një workshop të bërë nga NAMSA). Pra, dokumenti është përdorur si referencë edhe në prezantime publike. Në çështjen objekt shqyrtimi, Qendra "Res Publica" nuk kërkon të dijë detaje sekrete, por të njihet me vlerësimin e bërë për Uzinën Mjekës, për sa kohë informacioni nuk përbën sekret shtetëror apo tregtar të argumentuar.

Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr.1101/6 prot, datë 24.11.2015 sqaron se dokumentacioni që kërkon Qendra "Res Publica" nuk mund t'i vihet në dispozicion për arsyet e mëposhtme:

Studimi/dokumentacioni që kërkohet nuk është një punim/studim apo dokumentacion shkresë e kryer dhe prodhuar prej Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe nuk është pronë e saj. Gjithashtu autor i këtij studimi nuk është subjekti i Ministrisë së Mbrojtjes. Ky studim nuk është bërë më fondet e ministrisë, por të Shtetit Zvicërian. Studimi ka autor të huaj dhe Ministria e Mbrojtjes nuk mund të verë në dispozicion të palës kërkuese një studim/punim që është i një autori tjetër të huaj, pasi do të çenohej e drejta e autorit.

Bazuar në Ligjin nr.9380, datë 28.04.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", Ministria e Mbrojtjes nuk ka të drejtë të shpërndajë në mënyra të ndryshme kopje të këtij studimi, pasi çënon në këtë mënyrë të drejtën e autorit. Vetë autori/studiuuesi, në faqen e dytë të studimit, ka përcaktuar personat të cilëve do t'u

shpërndahet nga një kopje e këtij studimi. Në këtë listë të ngushtë nuk ben pjesë subjekti i interesuar.

Materiali/studimi që kërkohet është për përdorim të brendshëm. Pra është një studim i kryer nga një autor i një autoriteti të huaj publik (autoriteti që ka urdhëruar klasifikimin) dhe vetëm për përdorim të brendshëm. Sqarojmë se në fund të çdo faqeje të këtij studimi, është shënuar se ky material/studim është vetëm "për përdorim të brendshëm". Veç të tjerash ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit, në nenin 17 të tij, shkronjat "c" dhe "ë" përcakton se: "E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, propocionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtme:

c)-të drejtën e autorit

ë)-mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose qeveritare".

Sa më sipër kemi një studim me një autor, dhe së dyti kemi një studim të një autori të huaj, të një institucioni të huaj, të klasifikuar prej tij dhe të kryer për interes të FA-së së Shqipërisë. Nëse informacioni do të jepej pa autorizimin ose pëlqimin e autorit përkatës të institucionit të huaj, do të dëmtonte mbarëvajtjen e marrëdhënies ndërkombëtare dhe qeveritare mes dy vendeve tona. Për sa më sipër, studimi i kryer, është klasifikuar vetëm për përdorim të brendshëm edhe nga vetë autori.

Në përgjigjen që Ambasada Zvicerane i ka dhënë Qendrës "Res Publica", shprehet se ky studim "nuk është për publikun", pra është i klasifikuar. Ministria nuk mund të vendos në dispozicion një studim pronë të një autori të huaj, i cili ka dhe të drejtën e shpërndarjes apo bërjes publike të këtij studimi, pasi do të shkelte e cënonte ligjin nr.9380, datë 28.04.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të". Po ashtu studimi nga vetë autori është përcaktuar për shpërndarje për vetëm një numër të kufizuar personash dhe vetëm për përdorim të brendshëm, duke përfshirë edhe Forcat tona të Armatosura (FA).

Për arsyet e mësipërme Ministria e Mbrojtjes nuk mund të vendosë në dispozicion të palës kërkuese studimin "Vlerësimi paraprak i riskut mjedisor të ekspozivëve në Fabrikën e Mjekësit, Shqipëri".

Pas shqyrtimit të ankesës, parashtrimeve, seancës dëgjimore, si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezulton se informacioni i kërkuar është informacion publik. Në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit 119/2014, informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik.

Studimi i sipërcituar është hartuar nga një autor i huaj dhe është klasifikuar për përdorim të brendshëm nga vetë autori. Por në zbatim të ligjit nr.8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", i ndryshuar, Autoriteti Publik/Ministria e Mbrojtjes, nuk ka filluar asnjë procedurë për klasifikimin e këtij studimi. Bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", i ndryshuar, Autoriteti Publik/ Ministria e Mbrojtjes duhet të kishte përmbyshur menjëherë detyrimin për të nisur procedurën e klasifikimit të studimit (pjesërisht apo në tërësi) duke u legjitimuar në këtë mënyrë për mos dhënien e informacionit të kërkuar në këtë studim.

Për sa i përket mbarëvajtjes së marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare, pavarësisht nga sa parashikohet në paragrafin e parë, të pikës 2, të nenit 17, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.

Në Konventën e Aarhusit, me qëllim mbrojtjen e të drejtës së çdo individi të brezave të sotëm e të ardhshëm, për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij, çdo palë do të garantojë të drejtën e publikut, për të patur informacion për mjedisin, për të

marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'iu drejtuar gjykatës, në lidhje me çështje të mjedisit.

Gjithashtu, nuk rezulton që nga ana e Autoriteti Publik/ Ministria e Mbrojtjes të jetë kryer balanca për prevalimin e sigurisë kombëtare sipas përkufizimit të bërë në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", i ndryshuar si dhe legjislacioni për kufizimin e të drejtës për informim me interesin publik konform ligjit për të drejtën e informimit.

Theksojmë, se e drejta për t'iu informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "Res Publica" ndaj Autoritetit Publik/Ministria e Mbrojtjes, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "Res Publica", Nr. 1101 Prot., datë 28.10.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Ministrisë së Mbrojtjes, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Ministrisë së Mbrojtjes, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (*kopje të studimit "Vlerësimi paraprak i riskut mjedisor të eksplozivëve në Fabrikën Mjekës, Shqipëri"*), brenda datës 05.02.2016.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 25.01.2016.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI

